

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQERISE  
“NBB” SH.P.K.**

Ne baze te ligjit 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, i ndryshuar, si dhe ne perputhje me Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur dhe me nenshkrimin e Akt Themelimit & Statutit, **sot më datë 03.01.2024, ortaku i vetem shoqerise**, shpall si me poshte vijon:

**NENI 1  
FORMIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Formohet shoqeria e quajtur “NBB” SH.P.K. (qe me poshte do te quhet “Shoqeria”) me ortakun e vetem:
- Z. Shpati Braho, i datëlindjes 20.03.1986, i lindur në Potom dhe banues në, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal I60320003J, leshuar me date 20.014.2021:

**NENI 2  
SELIA E SHOQERISE**

- 2.1 Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen:** TIRANË, Rr.: KAVAJES, Nr. ap.: 5.
- 2.2 Gjate ushtrimit te aktivitetit te saj Shoqeria mund te hape dege dhe zyra perfaqesimi kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise.

**NENI 3  
KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE**

- 3.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar.

**NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

- 1.2 Kjo shoqeri do te kete veprimtari aktiviteti “*Instalime elektrike, hidraulike, punime gipsi, lysterje, suvatimeve etj.. te ndertesat e banimit, objekteve civile, etj.*”

**NENI 5  
REGJIMI JURIDIK I SHOQERISE**

- 5.1 Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqëndrimin, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve dhe ne perputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.
- 5.2 Shoqeria drejtohet sipas parimeve te ekonomise se tregut dhe ka qellime fitimi.
- 5.3 Shoqeria eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar e atij civil ne fuqi.
- 5.4 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mundet qe te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me dispozitat ligjore qe do te jene ne fuqi si dhe ne perputhje te plote me dispozitat e Aktit te Themelimit dhe te Statutit te saj, duke bere edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.
- 5.5 Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria ka vulen e saj.

**NENI 6**  
**KAPITALI I SHOQERISE**

6.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100000 (njeqind mije) Leke .Zoteruesit e kapitalit do te jene sipas tabelës me poshte:

	ORTAKU	PERQINDJA E KUOTAVE	KUOTAT	VLERA NE LEKE
1	Shpati Braho	100 %	1	100000 Leke

6.2 Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

6.3 Ortaket jane pergjegjes kundrejt paleve te treta per humbjet qe peson Shoqeria, deri ne shumen e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

6.4 Kapitali themeltar mund te zmadhohet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore.

**NENI 7**  
**KUOTAT**  
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E LIDHURA**

7.1 Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote.

7.2 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratoreve ("Regjistri i Ortakeve").

7.3 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo

7.4 Ortaket; (ii) numrin dhe vlerën e kuotave qe i perkasin cdo Ortaket; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaket; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

7.5 Kuotat jane lirisht te transferueshme nepermjet trashegimise apo ndermjet Ortakeve ekzistues.

7.6 Kalimi i te drejtave te pronesise, venia peng, barre apo çdo mjet tjeter sigurimi mbi kuotat do te kerkoje, ne menyre qe te prodhoje efekt, miratimin paraprak te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila vendos me shumice te thjeshte.

7.7 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje ne cdo forme te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij nje personi te ndryshem nga Ortaket deri ne limitin e paketes kontrolluese te shoqerise, secili prej Ortakeve te tjere ka te drejten e parablerjes mbi nje numer kuotash ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin themeltar, ne varesi te faktit se sa ortake do te ushtrojne te drejten e parablerjes ne rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetem ne perputhje me proceduren ne vijim.

7.8 Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjitha apo nje pjese te kuotave te tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te trete te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuotat dhe kushtet esenciale te transferimit.

7.9 Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaket per shitjen apo transferimin e planifikuar - do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.

Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

7.10 Administratoret brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortaketn qe deshiron te transferoje kuotat e tij.

7.11 Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejta e parablerjes, ata do te blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.

Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.

- 7.10 Administratoret brenda 10 (dhjete) diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortaketn qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.11 Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejttat e parablerjes, ata do te blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.12 Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak sipas nenit 7.9 me siper, Ortaket qe ka per qellim te transferoje kuotat e tij do te jete i lire t'ia transferoje keto kuota personit/ave te percaktuar.
- 7.13 Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuotat objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit te percaktuar nga neni 7.9 me siper.
- 7.14 Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.
- 7.15 Ne rast te vendimit per transferimin e kuotave tek te tretet, Asambleja e Pergjithshme e shoqerise nuk do te transferojë paketen kontrolluese te aksioneve në favor të ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

## **NENI 8**

### **ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

- 8.1 Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji.
- 8.2 Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejttat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuota e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.
- 8.3 Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.
- 8.4 Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

## **NENI 9**

- 9.1 Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejttat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

## **NENI 10**

### **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

- 10.1 Organet e shoqerise jane:
  - 1- Asambleja e Ortakeve.
  - 2- Administratori.

## **NENI 11**

### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

- 11.1 Organi me i larte i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve e cila mund te thirret nga çdo anetar i shoqerise qe perfaqeson te pakten 5% te kapitalit te shoqerise. Antaret duhet te njoftohen me shkrese

ose nepermjet postes elektronike, jo me vone se 7 dite perpara dhe ne lajmerim duhet te jete shkruar vendi, ora dhe ceshtjet e rendit te dites qe do te trajtohen ne mbledhje.

- 11.2 Neqoftese Asambleja nuk eshte mbledhur sipas rregullave te caktuara ajo mund te marre vendim kur çdo anetar i shoqerise eshte prezent dhe jane dakort te marrin vendime pavaresisht parregullsise.

## NENI 12

### TE DREJTAT DHE KOMPETENCAT

#### E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
  - b. ndryshime te Statutit;
  - c. emerimi dhe shkarkimi i Administratoreve;
  - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
  - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d.;
  - f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
  - g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
  - i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
  - j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
  - k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
  - l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
  - m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
  - n. ceshtje te tjera sipas parashikimeve te ketij Statuti.
- 12.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
- 12.3 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.
- Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktoje qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithë Ortakeve, adresen e faqes se internetit te Shoqerise ku mund te merret informacioni, po ashtu edhe rendi i dites, dhe duhet t'u njoftohet te gjithë Ortakeve te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo ceshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.
- 12.4 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.
- 12.5 Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

- 12.6 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese ose kufizojne / zvogelojne te drejtat qe u jane njohur ortakeve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakett te interesuar / perkates.
- 12.7 Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret jane pergjegjes per mbajtjen e nje kopjeje te tij.

### **NENI 13**

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise.
- 13.2 Mbledhja e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise.
- 13.3 Asambleja e pergjithshme thirret nese:
- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
  - shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
  - shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

### **NENI 14**

#### **THIRRJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

- 14.1 Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, me njoftim nepermjet postes elektronike.
- 14.2 Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 14.3 Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsi

### **NENI 15**

#### **KORUMI I NEVOJSHEM DHE VENDIM-MARRJA**

- 15.1 Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.
- 15.2 Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike.
- 15.3 Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se korumit te permendur me siper, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite. Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- 15.4 Per ceshtjet e tjera, asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. f do kuote jep te drejten e nje vote.



- 15.5 Ortaket, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike.

#### **NENI 16**

##### **PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE**

- 16.1 Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.
- 16.2 Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetanit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarrsesve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.
- 16.3 Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.

#### **NENI 17**

##### **ADMINISTRIMI**

- 17.1 Asambleja e Pergjithshme emerone nje ose deri ne tre persona fizik si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet, me te drejte riprertitjeje. Ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, Asambleja e Ortakeve vendos shkarkimin e administratorit duke treguar me fakte demin qe i eshte shkaktuar shoqerise nga paaftesia e tij pasi eshte dhene mendimi per kete dem edhe nga specialistet perkates.
- 17.2 Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 17.3 Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar me te tretet ne emer te shoqerise dhe ne interes te saj ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoqerise, si me siper, ua jep shprehimisht ortakeve.
- 17.4 Administrator i shoqerise eshte:
- **Z. Shpati Braho**, i datelindjes 20.03.1986, i lindur ne Potom dhe banues ne, Tiranë, person madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. Personal I60320003J, leshuar me date 20.014.2021:

#### **NENI 18**

- 18.1 Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe ne Statut qe i takojne Asamblese se Ortakeve.

#### **NENI 19**

- 19.1 Administratori ka te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme per furnizime publike private, te ndermarre veprime gjyqesore per dhe ne emer te shoqerise, etj. Administratori mund te jape prokura ne kufijte qe i lejon Asambleja e Ortakeve per kategori te caktuara veprimesh. Perfaqesimi ligjor i shoqerise eshte i vlefshem per cdo veprim gjyqesor apo jashtegjyqesor.
- 19.2 Administratori eshte i detyruar te mbaje konform ligjit te gjitha rregjistrat e domosdoshme per aktivitetin e shoqerise. Administratori i shoqerise eshte i detyruar te mbaje inventare te rregullta. Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore, hartohen nga Administratori.
- 19.3 Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me parjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi apo mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

- 19.4 Administratori është përgjegjës për administrimin e shoqërisë dhe informon ortakët për ecurinë e veprimtarisë tregtare të shoqërisë. Gjate veprimtarisë së tij ai vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë, duke zbatuar parimet e detyrimit të besnikërisë.

#### **NENI 20**

##### **MARREDHENIET E PUNES**

- 20.1 Marredheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislativës së punës në fuqi. Shoqëria private merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demot që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **NENI 21**

##### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

- 21.1 Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha aktet dhe dokumentet që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i kësaj shoqërie.

#### **NENI 22**

##### **EKSPERTET OSE REVIZORËT KONTABEL**

- 22.1 Kontrolli mbi veprimtarinë e Administratorit, veprimtarinë e tij si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizorit kontabel. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për atë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja e Ortakëve cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

#### **NENI 23**

##### **BILANCI DHE NDARJA E FITIMEVE**

- 23.1 Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të mbyllet në dt. 31 Dhjetor të çdo viti. Administratori merr masë për hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventar. Pasi veçohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten ndahen midis ortakëve dhe mund të transferohen lirisht jashtë shtetit sipas dispozitave përkatëse ligjore.

#### **NENI 24**

##### **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

- 24.1 Shoqëria prishet (i) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve; ose (ii) në rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR; ose (iv) me vendim gjykates; ose (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.
- 24.2 Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit nga Administratoret.
- 24.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e përgjithshme. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.
- 24.4 Çdo person i interesuar, ka të drejtë t'i kërkojë gjykates zëvendësimin e likuiduesit, sipas vendimit të ortakëve, nëse paraqet arsye të mjaftueshme për të dyshuar se likuidimi i rregullt i shoqërisë mund të cenohet nga likuiduesit e emëruar si me siper. Kërkesa duhet të depozitohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e caktimit të likuiduesit.
- 24.5 Gjykata emëron likuiduesin, në rastet kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykates. Likuiduesit shkarkohen dhe zëvendësohen me të njëjtat kushte, të parashikuara në dispozitat për emerimin e tyre.

- 24.6 Administratoret e shoqerise i njoftojne per regjistrim, Qendres Kombetare te Regjistrimit te dhenat e likuiduesve te pare dhe tagrat e tyre, per te perfaqesuar shoqerine, se bashku me dokumentet perkatese. Likuiduesit depozitojne nenshkrimin e tyre.
- 24.7 Likuiduesit i njoftojne, gjithashtu, Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim gdo ndryshim per identitetin dhe tagrat e tyre te perfaqesimit. Emerimi i likuiduesve nga gjykata regjistrohet ex officio, sipas nenit 45 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- 24.8 Likuiduesit duhet te ftojne kreditorët e shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e saj. Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

#### **NENI 25**

#### **TE DREJTAT E DETYRIMET E LIKUIDUESIT**

- 25.1 Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.
- 25.2 Likuiduesi mund te kryeje edhe veprime te reja tregtare, per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar. Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnr proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

#### **NENI 26**

#### **LIBRAT E SHOQERISE**

- 26.1 Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:
- Libri i Ortakeve
  - Libri i Mbledhjeve
  - Libri i vendimeve te organit administrativ
  - Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.
- 26.2 Librat e mesiperme duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

#### **NENI 27**

#### **SHPERNDARJA E AKTIVEVE**

- 27.1 Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shperndan ortakeve apo aksionareve aktivet e mbetura, sipas te drejtave qe ata kane ne ndarjen e fitimeve, me perjashtim te rastit kur statuti parashikon radhe preference.
- 27.2 Pasurite, qe i jane dhene shoqerise me qira apo ne perdorim, me cfaredo titulli u kthehen ortakeve apo aksionareve.
- 27.3 Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon c'regjistrimin e shoqerise.

#### **NENI 28**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

- 28.1 Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.
- 28.2 Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 28.3 Gjithçka nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- 28.4 Ky Statut perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqip me te njejten vlere, dhe nenshkruhet pa verejtje nga ortakët themelues.




**ORTAKU I SHOQERISE**

**NBB" Sh.p.k**

**Shpati Braho**

*S. Braho*

A stylized handwritten signature in blue ink, consisting of several fluid, overlapping strokes.